



Mesazhet nga Brukseli për Shqipërinë në pritje të Progres Raportit  
BE i dorëzon Kosovës Udhërrëfyesin e vizave: shqetësime për kushte shtesë  
Të drejtat e pasagjerit: Aplikimi i ri në telefon jua afron në çdo kohë

# EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.10, Korrik - Gusht 2012

## Speciale

### Politikat e punësimit duhet t'i përgjigjen realitetit të shoqërisë shqiptare

*Lëvizja Europiane në Shqipëri risjell në vëmendje çështje të papunësisë dhe nevojës së hartimit të politikave më të mira të punësimit*

**Pasqyrë e tregut të punës në Shqipëri:** Shqipëria renditet mes atyre vendeve, ku pavarësisht valëve të ndryshme të rritjeve ekonomike, papunësia ka mbetur gjithnjë e lartë dhe një problem shqetësues. Sipas të dhënave të INSTAT-it, për tremujorin e parë të vitit 2012 papunësia është në nivelin 13.32%. Kjo shifër merr parasysh vetëm punëkërkuessit e regjistruar, të cilët arrijnë numrin 143,421 dhe nuk merr parasysh banorët në fshat të cilët konsiderohen të vetëpunësuar.

Shqipëria ka fatin të jetë një nga vendet e rajonit me moshën më të re të popullsisë në moshë pune (15 – 64 vjeç) pra një kapital njerëzor

...vijon në faqen 2 >>

### Jo vetëm diell: Vera rizgjon artin në Ballkan Dokufest: Një Festival Filmi në Prizren



Edhe këtë vit sikurse është bërë traditë, në Prizren u organizua edicioni i njëmbëdhjetë i festivalit të film-it ku përgjatë një jave u transmetuan 160 filma të kategorive të ndryshme. Disa nga filmat të cilat u vlerësuan me çmim ishin: "Sofia's Last Ambulante", i autorit Ilian Metev nga Bullgaria u shpall doku-mentari më i mirë në Ballkan; "Tea or Electricity" i Jerome le Maire nga Belgjika u shpall dokumentari më i mirë në kategorinë e dokumentarëve me metrazh të gjatë; "Platforma Luna" e Jury Ancaranit u vlerësua me çmimin e mirënjohjes; "Sack Barrow", i Ben

...vijon në faqen 4 >>

### Telashet për Europën vazhdojnë, ndërkohë turizmi rritet



### Presidenca më e pakëndshme

*Në gjashtë muajt e ardhshëm Qipro do të mbajë presidencën e radhës së BE-së, duke qenë në një pozitë të pafavorshme veçanërisht në lidhje me kërkesën për kreditim financiar dhe bojkotin turk.*

*Megjithatë, e përditshmja qipriote Phileleftheros, argumenton se një presidencë e suksesshme do të jetë mjaft e rëndësishme për të ardhmen e vendit dhe BE-në.*

1 korriku 2012, ishte një ditë historike për Republikën e Qipros, pasi ajo mori presidencën e radhës së BE-së për gjashtë muajt e ardhshëm.

...vijon në faqen 4 >>

## Politikat e punësimit duhet t'i përgjigjen realitetit të shoqërisë shqiptare

...vijon nga faqja 1 >>>

të vyer, rreth 64.3%. Por, një pjesë e konsiderueshme e punëkërkesve të papunë u përkasin pikërisht moshave të reja dhe konkretisht 15.6% e punëkërkesve të papunë i përkasin grupmoshës deri në 25 vjeç dhe 22.9% i përkasin asaj 25-34 vjeç. Një aspekt shqetësues mbeten punëkërkesit afatgjatë, të cilët përbëjnë rreth 66% të totalit. Gjithashtu, tregu i punës në Shqipëri karakterizohet nga aktiviteti i ulët rreth 62% në vitin 2009. Kriza ekonomike, e veçanërisht ajo në Greqi ka ndikuar drejtpërdrejtë të shumë emigrantë shqiptarë, duke i detyruar ata të kthehen në atdhe. Ndërkohë që në fillimet e krizës ishte parashikuar se këta persona mund të nxisin zhvillim në ekonomi në vendase duke hapur biznese të reja, në realitet, sipas burimeve të MPCSSH, 64% e tyre regjistrohen në sportelet e migracionit si punëkërkes të papunë.

Për t'i bërë ballë sfidave të papunësisë, qeveritë kanë hartuar politika të nxitjes së punësimit. Megjithatë, vëmendja që u kushtohet atyre në Shqipëri është e pakët. Konkretisht në vitin 2009, Shqipëria investonte për politikën e nxitjes së punësimit vetëm 0.016% të prodhimit të brendshëm bruto (PPB), një shifër qesharake në krahasim me mesataren e BE-së në atë periudhë prej 0.46% të PPB. Vlen të shtohet gjithashtu se buxheti aktual për programet e nxitjes së punësimit është përgjysmuar në krahasim me vitin 2010.

Shqipëria ndodhet në një moment të rëndësishëm reflektimi mbi gjendjen aktuale të tregut të punës. Plani kohor i zbatimit të Strategjisë Sektoriale të Punësimit dhe Formimit Profesional 2007 – 2013 është drejt shterimit dhe muajt në vijim do të jenë vendimtare për vlerësimin e gjendjes dhe rikonfigurimin më të mirë të politikave të punësimit. Ndërkohë, programi IPA 2-2014 – 2020 parashikon përfitimin nga të pestë komponentët, të vendeve në rrugën e anëtarësimit, pavarësisht marrjes apo jo të

statusit të vendit kandidat. Kjo do të thotë që në një të ardhme të afërt, Shqipëria do të mund të përfitojë dhe nga komponenti IV për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, në funksion dhe të pjesëmarrjes në të ardhmen në Fondin Social Europian.

Aktualisht në Shqipëri zbatohen pesë programe për nxitjen e punësimit, të cilat synojnë të ndihmojnë drejtpërsëdrejti punëkërkesit e papunë. Ato targetojnë gratë nga grupet e veçanta, personat në vështirësi, personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, studentët e diplomuar në 24 muajt e fundit në universitetet vendase ose të huaja. Megjithatë, dy prej programeve nuk disponojnë buxhet për vitin 2012, dhe në tërësi fondet - dhe rrjedhimisht dhe numri i përfituesve - mbeten modestë. Programet, të cilat marrin formën e trajnimit në punë ose subvencionimit për punësim për një kohë caktuar, shpesh herë karakterizohen nga një burokraci e lartë dhe mungesë transparence në zbatim, çka i dekurajon punëdhënësit të aplikojnë.



**Problematika dhe sugjerime për përmirësimin e politikave të punësimit:** Në një sfond krize ekonomike mbarë europiane dhe më gjerë, Shqipëria përballet me një nivel papunësie relativisht të lartë. Në tërësi, zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit përbën një aspekt pozitiv për Shqipërinë dhe një përvojë të ndjekur gjerësisht nga vendet ish-



komuniste, sot anëtare të BE-së. Megjithatë, ndikimi i këtyre programeve mbetet ende një temë e diskutueshme. Prandaj, fokusi duhet të jetë krijimi i vendeve të reja të punës, në mënyrë që punësimi i nxitur nëpërmjet programeve të ndryshme të jetë më i qëndrueshëm.

Për sa i takon Shqipërisë, deri më tani, programet e nxitjes së punësimit kanë pasur një ndikim të kufizuar. Kjo për një sërë arsyesish si:

- Ulja e ndjeshme e buxhetit ndër vite dhe rrjedhimisht kufizimi i numrit të përfituesve;
- Prania e burokracive të shumta çka i bën ato më pak joshëse për punëdhënësit;
- Programet nuk janë gjithnjë të konsultuara dhe të mirë-përshtatura me nevojat e subjekteve private - veçanërisht sa i takon trajnimeve dhe përfitimeve të parashikuara për punëdhënësin - në një kontekst ku informaliteti dhe papunësia mbeten problem;
- Në tërësi, zyrat e punësimit të cilat janë dhe zbatuesit e këtyre programeve, nuk gëzojnë popullaritet të lartë mes qytetarëve dhe bashkëpunimi i tyre me subjektet private mbetet i kufizuar.

### *Rekomandime për politikbërësit*

- Politikat e nxitjes së punësimit duhet të marrin më shumë vëmendje dhe fonde në planin afatgjatë. Përkundër prirjes aktuale, buxheti duhet të vijë duke u rritur dhe programet të zgjerojnë rrethin e përfituesve.
- Duke pasur parasysh se programet që nxisin punësimin në sektorin publik në përgjithësi kanë pasur ndikim të kufizuar në uljen e papunësisë, fokusi duhet të jetë në nxitjen e sa më shumë rasteve të punësimit në sektorin privat.

- Të ushtrohen kontrole më të rregullta me qëllim uljen e informalitetit, shoqëruar me avantazhe më të mëdha për punëdhënësit që punësojnë punëkërkues të regjistruar.
- Të garantohet mbështetje me më shumë mjete financiare të zyrave të punësimit për ofrim shërbimesh sipas standardeve të BE-së (burime njerëzore të alokuara në raport me numrin e punëkërkuesve).
- Shërbimet duhet të shtrihen e zhvillohen edhe në zonat rurale bazuar në përvojën e vendeve të BE-së.

### *Rekomandime për Shërbimin Kombëtar të Punësimit*

- Të vendosen kontakte më të qëndrueshme dhe bashkëpunim i mirëfilltë me sa më shumë subjekte nga zyrat vendore të punësimit, me qëllim përcaktimin më efektiv të programeve, veçanërisht sa u takon trajnimeve.
- T'i jepet më shumë rëndësi ndjekjes (follow-up) të personave përfitues në programet e nxitjes së punësimit si mënyrë për të vlerësuar efikasitetin e tyre.
- Të bëhet promovimi aktiv i zyrave të SHKP-së për sektorin privat për të përforcuar rolin e tij si këshillues dhe ndërmjetësues. Këto zyra të gëzojnë besim më të madh nga ana e bizneseve në depozitim të ofertave të punës dhe nga ana tjetër zyrat e punësimit duhet të përmirësojnë shërbimet e para seleksionimit dhe dërgimin në një kohë sa më të shpejtë të bizneset të personave me aftësi të përshtatshme për vendet e lira të punës.
- Në tërësi, nevojitet ndryshimi i mentalitetit në opinionin publik mbi shërbimet e zyrës së punësimit si një zyrë që orienton dhe mbështet punëkërkuesin për të gjetur punë dhe jo si një zyrë që lëshon vërtetime.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2012*



## Telashet për Europën vazhdojnë, ndërkohë turizmi rritet

...vijon nga faqja 1 >>

Kjo është hera e parë që Qipro që prej 2004 vitit të anëtarësimit në BE, po përballet me një sfidë të tillë. Europa është duke kaluar një kohë të vështirë, sidomos në aspektin financiar, dhe Qiproja do të përpiqet të gjejë një gjuhë të përbashkët me shtetet anëtare për të dalë nga kriza. Detyrë e vështirë kjo për një ishull të vogël pa përvojë të mëparshme dhe kapacitet të kufizuar.

Gjithsesi, mungesa e përvojës dhe madhësisë së një vendi jo gjithmonë është një faktor pengues në kuadër të arritjes së suksesit.

### Bojkoti turk

Turqia, e cila zë pjesën veriore të ishullit, ka vendosur të bojkotojë Presidencën qipriote dhe të pezullojë bisedimet e nivelit të lartë me BE-në për gjashtë muaj.

### Është e qartë se nuk kishte kohë më të keqe për të kërkuar ndihmë

Ndërkohë qipriotët nguten të sqarojnë se ata nuk e demonizojnë mekanizmin e ndihmës, por pranojnë se ishte një gabim t'i kërkonin ndihmë fondit të kreditimit vetëm disa ditë përpara marrjes së presidencës së BE-së. Kjo për shkak se vëmendja tani do të jetë e përqendruar në këtë çështje dhe shumë nga të mirat që mund të vijnë nga një mandat në krye të BE-së do të humbasin.

Kjo është arsyeja pse ne besojmë se qeveria duhet të kishte kërkuar ndihmë më herët, kur ajo e kuptoi se rekursi ndaj mekanizmit për kreditim ishte i pashmangshëm.

*PressEurop, 2 korrik 2012*

## Jo vetëm diell: Vera rizgjon artin në Ballkan Dokufest: Një Festival Filmi në Prizren

...vijon nga faqja 1 >>

River nga Mbretëria e Bashkuar është shpallur dokumentari ndërkombëtar më i mirë me metrazh të shkurtër. Gjatë festivalit u vu re se kishte një larmishmëri filmash për sa i përket tematikës së trajtuar. Çështja e të drejtave të njeriut ishte në qendër të filmit "Call me Kuchu", të Katherine Fairfax Wright dhe Malika Zouhali-Worall, nga SHBA-ja. Ndërkohë filmi i regjisores britanike Emily James "Just Do It - A Tale of Modern Day Outlaws, trajton çështjen e mjedisit duke u përzgjedhur kështu dokumentari më i mirë në këtë zhanër. Krahas autorëve ndërkombëtarë të vlerësuar me çmime, në festival morën pjesë edhe dy autorë shqiptarë, Sabir Kanaqi dhe Sokol Keraj. Filmi "Matanë Lumit" i Sabir Kanaqit mori çmimin e filmit më të mirë, ndërsa filmi "Dita e Fundit e Loro Shehanit", i regjisorit Sokol Keraj ka fituar çmimin e publikut për këtë edicion.

Pjesë e filmave të transmetuar gjatë Dokufest, krahas filmave për të rritur ishin edhe ata kush-tuar fëmijëve. Një i tillë ishte "Machinarium" ku fëmijët patën rastin të punonin bashkërisht për të prodhuar një film, karakteret e të cilit krijoheshin nga materialet ricikluese.

Për sa i përket atmosferës mbizotëruese regjisorit belg Valery Roiser tha se që nga momenti kur ka arritur në Prizren ka mbetur i mahnitur nga pamjet dhe gjallëria në rrugët e qytetit.

*Koha Ditore, 15 korrik 2012*

### Festivali i Filmit në Sarajevë

Sivjet u mbajt edicioni i 18-të i festivalit të filmit në Sarajevë, i cili është aktiviteti më i rëndësishëm për kinemanë në Ballkan. Ai shërben si forum i shkëmbimit të ideve midis shumë regjisorëve e aktorëve të rajonit dhe më gjerë.

Gjatë festivalit, i cili u zhvillua në datat 6 – 14 korrik, u shfaqën filma me metrazh të shkurtër dhe dokumentarë nga e gjithë bota. Çdo vit ky takim artistësh është në kërkim të ideve të reja dhe madje në bashkëpunim me Festivalin e Filmit në Berlin, ka krijuar dhe Kampusin e Talenteve. Nga vetë emri, kampusi është një hapësirë eksperimentimi me rryma të reja nga artistë të rinj nga rajoni dhe e gjithë bota. Çdo vit festivali përmban 13 programe dhe ndiqet nga rreth 100 000 vetë. Këtë vit, në hapjen e tij morën pjesë dhe aktorët Angelina Jolie dhe Jeremy Irons.

## EXIT Festival

Është zhvilluar mes datave 12- 15 korrik, në kalanë e Petrovaradinit, me një pamje magjike mbi lumin Danub. Exit Festival vazhdon të mbetet më shumë sesa një festival, ai është një aventurë e vërtetë në Ballkan. Magjia e tij buron edhe nga fakti se EXIT festival është shtëpia e Arena Dance, e njohur botërisht për energjinë e pabesueshme. Në një ambient që mbledh çdo vit 20 000 të rinj nga e gjithë bota, aty luhet pa ndalim muzikë e rrymave të ndryshme si techno, elektro, house etj., për të kënaqur shijet e gjithkujt. EXIT zhvillohet në një peizazh unik natyror dhe historik, në një nga perlat e Ballkanit, qytetin e Novi Sadit në Vojvodinë, Serbi. Këtë vit performuan mbi 600 artistë në skena të improvizuara në rrugët me kalldrëm, tunele dhe brenda mureve të kalasë.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2012*



Foto: [www.flickr.com](http://www.flickr.com)

## Kartolina nga BE-ja

### Marrëdhëniet BE – SHBA mbeten komplekse

Në nëntor të vitit 2010 në Lisbonë, NATO-ja përpunoi dhe përshtati Konceptimin e ri Strategjik të organizatës për 10 vitet e ardhshme. Mbrojtja territoriale konfirmohet si detyrë qendrore e saj, por kërkohet modernizimi i veprimeve, për t'i bërë ballë formave jo tradicionale të kërcënimeve terroriste, përhapjes bërthamore dhe armëve të shkatërrimit në masë, si dhe sulmeve informatike. Amerika u përpoq ta vinte Europën para përgjegjësive të veta, duke i treguar se mund ta përballojë kërcënimin, vetëm nëse do të ndryshojë rrënjësisht mënyrën e bashkëveprimit të saj me Amerikën dhe me pjesën tjetër të botës. Ambasadori amerikan në NATO theksoi se organizata nuk e ka objektivat të saj të jetë një aleancë globale nga shtrirja gjeografike, por ajo do të ketë një rol global.

Por as këto fakte nuk e zgjuan Europën nga mpirja e saj. Në të vërtetë europianët nuk arrijnë ta mbështesin strategjinë e re të Amerikës në kuadrin ndërkombëtar, por nga ana tjetër as të prodhojnë vetë një veprim alternativ.



Ministri i mbrojtjes së Brazilit në konferencën e Lisbonës mbi të ardhmen e Komunitetit Transatlantik deklaroi se Brazili i kundërvihet pranisë së NATO-s në Atlantikun e jugut dhe çdo tentative për lidhje midis veriut dhe jugut të zonës atlantike. Sipas tij, NATO-ja është transformuar në një mjet për të pohuar interesat e Amerikës në botë dhe ai kritikoi vartësinë e skajshme europiane ndaj aftësive ushtarake amerikane në gjirin e NATO-s.

Në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes shtetet anëtare ruajnë një ndjenjë të fortë sovraniteti



kombëtar, duke marrë pjesë në NATO si aleatë individualë dhe duke e lejuar përfaqësuesin e lartë të saj të veprojë rrallë në nivel europian. Si rezultat, dështimi i Europës në përfaqësimin e një aktori efektiv të sigurisë ndërkombëtare është i qartë. Nga ana e saj, SHBA-ja mendon se një Europë e bashkuar do të ishte më e dobishme ndaj qëllimeve të saj strategjike, sesa Europa aktuale, por nuk është detyrë e amerikanëve të marrin nisma që ta shtyjnë Europën të bëhet e tillë.

Në deklaratën e diplomatit të lartë amerikan Gordon thuhet: “Ne dëshirojmë të shohim një Europë të fortë dhe të bashkuar që flet me një zë të vetëm. Në rastin më të mirë ai zë do të thoshte atë që ne dëshirojmë ta dëgjojmë... Nëse nuk do të thonin atë që ne duam të dëgjojmë, atëherë do të dëshironim që ai zë të ishte më pak unik”.

Sipas analistëve europianë, SHBA-ja, edhe pse ideologjikisht nuk është kundër procesit të integritimit europian, ajo nuk i privilegjon institucionet e BE-së në raport me Europën, por mban një rrjet lidhjesh të drejtpërdrejta me vende të ndryshme anëtare që nuk hezitojnë të veprojnë, sidomos kur institucionet europiane janë të paafta, që të japin një kontribut efikas në çështjet ndërkombëtare.

Raporti u sugjeron europianëve tema ku ata mund të kenë një pozicion autonom, si Afganistani, Rusia, Lindja e Mesme, ndryshimet klimatike, reformat e drejtimit global, rregullimi i financave ndërkombëtare, mbi të cilat amerikanët janë të interesuar të diskutojnë.

Nevoja e Europës për të biseduar e bashkuar për çështjet ndërkombëtare, përveç atyre ekonomike, përkthehet në apelin e pafund ndaj qeveritarëve që ta lënë mënjane egoizmin kombëtar dhe Europa të flasë me një zë të vetëm. Edhe apeli i radhës është i destinuar të shkojë në vesh të shurdhër. Qeveritë europiane luftojnë midis dy anëve të kundërta: të mbështeten në BE që ta forcojnë peshën në nivel ndërkombëtar ose t'i konkurrojnë partnerët europianë në

zonat e tyre të interesit. Përderisa nuk do të ketë një shtet federal europian me fuqi dhe burime të vetat në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes, të aftë të zëvendësojnë kombëtares, shtetet europiane, pa përjashtim, do të detyrohen të kërkojnë një mbrojtës të fuqishëm, mundësisht larg, duke shpresuar te fati i mirë dhe te dashamirësia e tij.

*Arjan Th. Kallço, korrik 2012*

## Mashtrimet masive me përdorimin e fondeve të BE-së, rrallë herë raportohen nga vendet anëtare



Kur u duhet të raportojnë dyshimet për mashtrim, korrupsion dhe veprimtari kriminale në Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit Financiar (OLAF), autoritetet e shteteve anëtare të BE-së duket se shpeshherë mbyllin një sy. Informacioni gjithnjë e më i kufizuar nga autoritetet publike po bëhet një shqetësim gjithnjë e më i madh. Nga 1046 rastet e raportuara nga burime publike dhe private në vitin 2011, vetëm 54 kanë ardhur nga autoritetet shtetërore. Më shumë se gjysma zakonisht vjen nga kompanitë private, avokatët, dhe individët anonimë. Ndër arsytet që i shtyjnë autoritetet shtetërore të mos i deklarojnë rastet e shkeljeve qëndron dhe frika se mos vendet e tyre etiketohen si të korruptuara në nivel europian. Sipas OLAF-it, abuzimet më të mëdha kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve strukturore, të cilat përbëjnë dhe pjesën më të madhe të buxhetit të BE-së dhe menaxhohen nga vendet anëtare. Vetëm për vitin 2011, hetimet e OLAF mundësuan rikuperimin e 691 milionë eurove. Shkelësit veprojnë më shumë në



ato shtete anëtare të BE-së ku legjislacioni penal është i dobët, me boshllëqe, ose kur ndjekja e këtyre rasteve është e pazakontë. Ryshfetet nuk janë domosdoshmërisht para në zarfe, por pagesa të bëra për një kompani të rreme të vendosur në një shtet tjetër anëtar.

Nga ana e tij, Komisioni European, do të propozojë së shpejti një direktivë që do të mbulojë në mënyrë specifike mashtrimin financiar. Ai gjithashtu shpreson të ngrihet zyra e Prokurorit, në gjysmën e parë të vitit 2013. Zyra fillimisht mendohet të ketë pushtet të hetojë dhe padisë krimet që prekin buxhetin e BE-së, por eventualisht mund të zgjerohet në sektorë të tjerë.

*EU Observer, 3 korrik 2012*

## **Pendesa e kryeministrit rumun**

Rumania po përjeton një krizë të ngjashme me atë të Hungarisë për sa i përket standardeve demokratike, gjë që ka ringjallur shqetësimin nëse BE-ja mund të mbrojë vlerat e saj thelbësore në demokracitë e reja.

Problemet në Rumani kanë filluar me ardhjen në pushtet në maj të këtij viti të qendrës së majtë të kryeministrit Viktor Ponta, i cili menjëherë u përplas me Presidentin konservator, Traian Basesku. Disa javë më parë, parlamenti votoi pezullimin e Presidentit në pritje të një referendumi që do të vendos mbi fajësimin e tij ose jo,



i cili do të mbahet në 29 korrik. Kjo situatë çoi në përplasje lidhur me një ligj të miratuar nga qeveria e mëparshme në ditët e saj të fundit, sipas të cilës që një referendum të ishte i vlefshëm kërkonte votimin prej të paktën 50 % + 1 të gjithë elektoratit. Qeveria e z. Ponta kishte kërkuar heqjen e kësaj kërkesë me dekret duke ndryshuar kështu rregullat e referendumit sipas të cilit largimi i presidentit mund të bëhej me një shumicë të thjeshtë. Një veprim i tillë u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese.

Fillimisht, qeveria tregoi se do ta injoronte vendimin e gjykatës. Por gjatë vizitës së tij në Bruksel, z. Ponta tha: "Unë nuk jam diktator. Qeveria ime do të respektojë vendimin e gjykatës, edhe nëse kjo do të thotë që z. Basesku të mbetet president". Konflikti ndërmjet presidentit dhe kryeministrit vjen në një kohë kur Rumania finalizoi marrëveshjen mbi paketën e ndihmës ekonomike mbështetur nga FMN. Qeveria e Ponta-s është kritikuar ashpër nga Kancelarja gjermane, Angela Merkel për thyerje të vazhduar të normave demokratike që me ardhjen në pushtet.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2012*

## **Draghi: Banka Qendrore Europiane duhet të bëhet më e përgjegjshme**

Në takimin mujor të Këshillit Drejtues së Bankës Botërore në Frankfurt u mor vendimi për të ulur normën kryesore të interesit me 0.25% dhe për ta çuar atë në 0.75%. Për herë të parë në historikun e eurozonës kjo normë është nën 1%. Kjo ulje është projektuar për të ndihmuar vende si Spanja dhe Italia, që kanë kosto të lartë huamarrëse dhe që janë duke marrë hua të mëdha nga BQE. BQE-ja gjithashtu ka ulur në zero normën e interesit për strukturën e depozitave si një përpjekje për të nxitur kredidhënien midis bankave.

Në takimin e Këshillit European më 28-29 qershor 2012, udhëheqësit e eurozonës ranë dakord për të bërë BQE-në mbikëqyrësin e për-



bashkët të sistemit bankar të eurozonës. Pritet që Komisioni European të propozojë brenda verës kuadrin legjislativ për këtë pozicionim të ri të BQE-së.

Draghi, Presidenti i BQE, e quajti këtë vendim si një hap mjaft të rëndësishëm por edhe me mjaft rreziqe. "BQE duhet të jetë në gjendje të bëjë këto detyra në mënyrë të pavarur dhe pa rrezikuar reputacionin e saj" tha ai. Ai shtoi se detyra mbikëqyrëse e bankës duhet të jetë e "ndarë në mënyrë rigoroze" nga roli i politikave të saj monetare. Sipas tij roli i ri i BQE-së kërkon "një nivel më të lartë të përgjegjësisë demokratike". Megjithatë, ai refuzoi të japë hollësira se çfarë do thotë kjo në realitet.

*EuropeanVoice, korrik 2012*

## Mali i Zi përballët me punë të vështirë në rrugën drejt BE-së

Së bashku me hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE të Malit të Zi më 29 qershor, zyrtarët europianë i dhanë një paralajmërim të madh vendit të vogël. Mali i Zi do të duhet të bëjë përpjekje të mëdha, veçanërisht në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, për të përfunduar negociatat me sukses. Në takimin e ministrave europianë në Luksemburg u kërkuar të nisin bisedime paraprake mbi çështje të ndjeshme si sundimi i ligjit, pavarësia e gjyqësorit dhe të drejtat themelore të njeriut "për të patur kohë të mjaftueshme për krijimin e legjislacionit të nevojshëm, të institucioneve dhe kushteve të zbatimit".

Në një raport të publikuar në qershor, Rosa Balfour, analiste politike në Qendrën e Politikave Europiane në Bruksel, shkruan se fakti që bisedimet po nisin me kapitujt më të vështirë zbulon të gjitha rezervat e BE-së mbi gatishmërinë e vendeve të Ballkanit.

Komisioni European tha se Mali i Zi do të jetë vendi i parë kandidat që do të fillojë negociatat

e anëtarësimit me sistemin e ri. Kapitujt 23 dhe 24, përkatësisht sistemi gjyqësor e të drejtat e njeriut dhe lufta kundër korrupsionit, do të hapen të parët dhe progresi në këto fusha do të monitorohet deri në mbylljen e negociatave.

*SETimes, korrik 2012*

## Londër: përgatitje origjinale për ceremoninë e hapjes së Olimpiadës

Tridhjetë dele, dymbëdhjetë kuaj, dhjetë pula, nëntë rosa dhe gjashtë oxhake, ishin elementët që përbënë sfondin e ceremonisë së hapjes së Lojërave Olimpikë. Këtë vit llogariten që në lojërat Olimpikë të marrin pjesë 10.500 atletë nga 204 vende të botës, të cilët do të performojnë para 1 miliardë shikuesve në mbarë botën.



Danny Boyle, i njohur për drejtimin e filmit "Slumdog Millionaire", i cili në Academy Award në 2009 mori çmimin e filmit më të mirë, është ideatori i krijimit të peizazhit rural në mes të Londrës lindore. Kjo me qëllim që të pasqyrohet një pjesë e trashëgimisë britanike. Mbretëresha Elizabeta II hapi zyrtarisht lojërat olimpikë më 27 korrik përmes një videoje të regjistruar ku Daniel Craig u paraqit si James Bond.

Njëkohësisht mendohet se pjesëmarrja e Muhamed Ali, i cili ka ndezur pishtarin në lojërat olimpikë të Atlantias në 1996, si dhe e lideres opozitare të Burmas, Aung San Suu Ki e cila u lirua pas 15 vitesh arrest shtëpie vitin e kaluar, do ti shtojë magjinë aktivitetit më të rëndësishëm sportiv të vitit. Gjithashtu, është zbuluar lajmi se Paul McCartney do të këndojë në ceremoninë e mbylljes me 12 gusht.

Në këto ditë debati në Britaninë e Madhe është përqendruar kryesisht tek aftësitë dhe talenti



i sportistëve vendas, me moton dhe idenë për të përdorur lojërat olimpike si “frymëzim për brezin e ri”.

Gazeta New York Times komentoi ceremoninë me fjalët: “Të premtën Britainia i prezantoi botës atë që ajo shpesh stërmundohet t’ia paraqesë edhe vetes së saj: një komb i sigurtë për identitetin e tij post-perandorak, çfarëdo qoftë aktualisht ai.”

*Stafi i EuroSpeak, qershor 2012*

## **Të drejtat e pasagjerit: Aplikimi i ri jua afron në çdo kohë**

Pasagjerët e bllokuar në aeroporte ose në pritje të bagazhit të humbur, tani mund të përdorin një aplikim në telefonat celularë dhe të kontrollojnë të drejtat e tyre në çast. Pikërisht në periudhën e pushimeve verore, Komisioni Europian ka krijuar një aplikim me informacione që mbulojnë transportin ajror dhe hekurudhor dhe punon në katër platforma celulare: iPhone dhe iPad, Google Android, Blackberry dhe Microsoft Phone Windows 7. Aktualisht ai mbulon vetëm transportin ajror dhe hekurudhor, por do të përfshijë dhe udhëtimet me autobus e anije që prej vitit 2013, kur këto të drejta të hyjë në fuqi.

Nëse një fluturim anulohet, një paketë pushimesh nuk rezulton ashtu siç është reklamuar, apo orari i trenit është ndryshuar - situata është shumë më e lehtë për t’u zgjidhur nëse udhëtari di të drejtat e tij. Për çdo problem, aplikimi shpjegon të drejtat e pasagjerit kur udhëton në vendet e BE-së, për shembull: nëse një fluturim anulohet, pasagjeri mund të ketë të drejtë për t’u kompensuar nga 125 € deri 600 €. Nëse bagazhi juaj është dëmtuar si pasojë e një aksidenti, ju gjithashtu mund të keni të drejtë për kompensim. Nëse ju mendoni se të drejtat tuaja nuk janë respektuar, aplikimi gjithashtu ofron informacion se kë duhet të kontaktoni për t’i drejtuar ankesën tuaj.

Për të shkarkuar aplikimin shkoni në: <http://ec.europa.eu/transport/passenger-rights/en/mobile.html> ose skanoni drejtpërdrejtë kodin QR:



*Stafi i EuroSpeak, korrik 2012*

## **Tarifat e reja për Roaming hyjnë në fuqi**

Për herë të parë BE-ja vendosi çmime tavan për shërbimin *roaming* në vitin 2007 (IP/07/870), duke siguruar që abonentët e telefonisë celulare të paguajnë tarifa *roaming* të përafërta në të gjithë BE-në, pavarësisht operatorit të përzgjedhur.

Që prej 1 korrikut 2012, Rregullorja e re Roaming ka hyrë në fuqi duke sjellë ulje të konsiderueshme të kostos së përdorimit të telefonave celularë në vendet e BE-së. Për herë të parë është vendosur dhe çmimi tavan për shkakimin e të dhënave nga interneti nëpërmjet telefonave celular. Çmimet për thirrje dhe mesazhe gjithashtu janë reduktuar.

Çmimet e reja tavan janë:

- 29 cent për minutë për të bërë një telefonatë, plus TVSH, nga 35 cent ekzistues;
- 8 cent për minutë për të marrë një telefonatë, plus TVSH, nga 11 cent ekzistues;
- 9 cent për të dërguar një mesazh të shkruar, plus TVSH, nga 11 cent ekzistues;
- 70 cent për Megabyte (MB) për shkarkimin e të dhënave plus TVSH.

Përveç çmimeve tavan, nga 1 korriku 2012, njoftimet e tanishme paralajmëruese që konsumatorët europianë marrin nëse po shpenzojnë një shumë të madhe parash, do të shtrihen dhe për vende jashtë BE-së.

*Stafi i EuroSpeak, 1 korrik 2012*



## Në pritje të aderimit...

### Ekonomitë e Ballkanit: kryesisht në mjerim

Një ndër gjetjet befasuese të anketave të zhvilluara gjatë dekadës së fundit në Ballkan është se me përjashtim të kosovarëve dhe shqiptarëve, të cilët kanë popullsinë më të re në moshë e si rrjedhojë më optimiste, shumica e njerëzve në Ballkan ndihen mjaft të zymtë. Ata janë të shqetësuar për vendet e punës, kujdesin shëndetësor, arsimin e fëmijëve dhe pensionet, më shumë sesa armiqësitë etnike apo dëshira për të rifituar territoret e humbura. Laza Kekiç nga Economic Intelligence Unit (EUI) pohon se ekonomitë e Ballkanit kanë qenë gjithmonë më të varfra se sa fqinjët e tyre perëndimorë dhe veriorë. Ato kanë përparuar vetëm atëherë kur këto ekonomi shkolin mirë dhe kanë vuajtur kur ato kanë pësuar kriza. Kriza e tanishme nuk është përjashtim.

Një tjetër analizë e kësaj njësie deklaron se ekonomitë në tranzicion të Ballkanit kanë vuajtur më shumë nga recesioni global i 2008-09. GDP reale në Ballkan nga 5.2% në vitin 2009 si pasojë e recesionit u zvogëlua mesatarisht me 0.4 % në 2010. Vitin e kaluar shumica e vendeve të ish-Jugosllavisë dhe Shqipëria përjetuan një rritje modeste. Ekonomia e Serbisë u rrit me 1.6 %, e Maqedonisë me 3%, e Bosnjës me 1.2 dhe e Malit të Zi me 2.2%. Megjithatë, këtë vit shkalla e rritjes është parashikuar të pësojë ulje.

Problemi kryesor për Ballkanin është mungesa e vendeve të punës. Në Serbi niveli i papunësisë në nëntor të vitit 2011 ishte 24%, një rritje prej 10% në krahasim me 2009. Në Bullgari papunësia mbetet në nivele relativisht modeste 11%. Megjithatë, këmbanat po bien, sidomos për vendet ekonomia e të cilave ndërthuret me ekonominë e rënduar greke dhe atë italiane. Lidhur me remitancat, Shqipëria është më e ekspozuara. Rreth 2/3 e emigrantëve në Greqi janë nga Shqipëria. Kudo në Ballkan qytetarët thonë se jeta është e vështirë. Pagat mesatare janë 491€ në Mal të Zi, 360€ në Serbi dhe në nivele të ngjashme gjetiu. Ndërkohë që çmimet janë të larta dhe në rritje, veçanërisht për shërbimet. Në këtë kontekst pyetja që EUI shtron është "A jemi ne dëshmitarët e qetë para

stuhisë së shkaktuar nga intensifikimi i krizës në ekonomitë europiane, në një kohë kur i vetmi faktor që kishte për qëllim stabilizimin e Ballkanit, BE-ja, është në mesin e të krizës së vet? E ardhmja ekonomike e Ballkanit varet nga fati i eurozonës.

*The Economist, 19 korrik 2012*

### Më në fund, BE i dorëzon Kosovës udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave: Disa zyrtarë të shqetësuar për kushte shtesë

Pas marrjes së udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave muajin e kaluar, zyrtarët e Kosovës shprehin shqetësimin se BE-së i mungon një qëndrim i përbashkët dhe si pasojë Komisioni Europian mund të përfshijë kushte shtesë, që do të ngadalësojnë procesin e integritimit.

Udhërrëfyesi përmban 95 kritere, që Kosova duhet të përmbushë për të siguruar udhëtimin pa viza për qytetarët e saj - duke përfshirë menaxhimin e kufijve dhe migrimit, sigurinë e dokumenteve, të ri-integritimit dhe ri-pranimin, masa kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

Kjo është përpjekja e parë e BE-së për ta përfshirë Kosovën, i mbetur i vetmi vend në rajon që nuk ka përfituar lëvizjen pa viza në zonën Shengen. Edhe pse Kosova është duke punuar për të përmbushur kriteret, zyrtarët thonë se lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe emigracionit të paligjshëm do të jetë sfiduese.

"Këto tri kritere, besoj do të shkaktojnë dhimbje të madhe koke, përkundër përparimit të konsiderueshëm në pikat e tjera", ka thënë Gëzim Kasapolli, zëvendës ministri për Integrimin Europian.

Prishtina premtoi që do t'i përmbushë kriteret e përcaktuara, për të cilat vendeve të tjera të rajonit i janë dashur një periudhë 13 deri në 22 muaj.

"Ne jemi të angazhuar për të përmbushur kriteret në një kohë rekord, por disa shkojnë përtej



kufijëve kombëtar, të tilla: si lufta kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimit kufitar “, tha Kasapolli. Një tjetër pengesë mund të jenë shtetet anëtare të BE-së - pesë nga 27 vendet që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. “Frika ime më e madhe është që ndërkohë mund të përfshihen kritere të tjera, të cilat do të vonojnë procesin,” tha Lutfi Haziri, Kryetar i Komisionit Parlamentar të Kosovës për Integrimin European. Avni Mazreku, drejtor i Kolegjit të Studimeve Europiane në Prishtinë, tha se ndërsa mungesa e një qëndrimi të përbashkët mund të çojë në kushte të reja, problemi është pasqyruar në marrëdhënie të përgjithshme, jo vetëm te procesi i liberalizimit të vizave afat shkurtër. Të pesë shtetet anëtare kanë ngadalësuar të gjitha llojet e bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës”, tha Mazreku.

*SETimes, 20 qershor 2012*

## Mesazhet nga Brukseli në pritje të Progres Raportit të vjeshtës

Më 11-12 korrik 2012, u mbajt Komiteti i pestë i Stabilizim-Asociimit Shqipëri – BE. Në pritje të Progres Raportit të 2012, ky takim ishte një mundësi e mirë për Shqipërinë për të reklamuar pranë autoriteteve të Brukselit punën e bërë gjatë kësaj periudhe. Ashtu si herën e fundit dhe ndryshe nga 3 mbledhjet e para të këtij komiteti, në fund të punimeve u ra dakord mbi konkluzionet e përbashkëta. Mesazhi i BE-së mbi ecurinë e Shqipërisë u kondensua në 8 pika kyçe:

1. Komiteti e përgëzoi Presidentin e ri të Shqipërisë, Bujar Nishani për zgjedhjen e tij dhe vlerësoi rolin e presidentit në ikje Bamir Topi si ndërmjetësues dhe pajtues gjatë krizës politike. Gjithashtu, u theksua se roli i Presidentit është themelor në bashkimin e kombit, për të siguruar stabilitetin dhe pavarësinë e institucioneve dhe për të bashkuar të gjitha forcat politike në përpjekjet për të plotësuar kushtet për anëtarësimin në BE.

2. Më tej, u përshëndetën përpjekjet e vazhdueshme të të gjitha forcave politike që t'i përm-

bahen marrëveshjes së nëntorit 2011, e cila u vu re se solli përmirësim në marrëdhëniet midis palëve. Megjithatë, zyrtarët e BE-së ishin të zhgënjyer për humbjen e një shansi nga të gjitha forcat politike për të treguar përkushtimin e tyre për bashkëpunim gjatë procesit të zgjedhjeve presidenciale.

3. Gjithashtu, u mirëpritën hapat e ndërmarrë për plotësimin e 12 prioriteteve kryesore dhe u përsërit thirrja për progres të mëtejshëm, duke theksuar në veçanti nevojën urgjente për të finalizuar reformën zgjedhore dhe atë parlamentare.

4. Komiteti theksoi edhe një herë se procesi i liberalizimit të vizave mbetet një sukses dhe një element thelbësor në zhvillimin e marrëdhënieve mes shoqërisë shqiptare dhe asaj europiane.

5. U ritheksua se reforma e gjyqësorit, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit janë parakushte kryesore për përparimin e gjithë rajonit drejt anëtarësimin në BE. Prandaj, Komiteti i bëri thirrje autoriteteve shqiptare që jo vetëm t'i japin përparësi procesit legjislativ, por edhe zbatimit, duke siguruar struktura organizative dhe buxhet të mjaftueshëm. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet gjithashtu forcimit të pavarësisë së gjyqësorit.

6. Sërish, Komiteti përsëriti rëndësinë e hetimit të plotë dhe të pavarur penal si dhe një procesi të besueshëm gjyqësor mbi ngjarjet e janarit 2011.

7. Ai u bëri thirrje autoriteteve shqiptare për të rritur disiplinën buxhetore dhe konsolidimin fiskal, në mënyrë që të ruajë stabilitetin makroekonomik dhe për të krijuar një mjedis të favorshëm për investime dhe rritje ekonomike, siç vërehet në të kaluarën. Gjithashtu u theksua se zgjedhjet e ardhshme parlamentare të 2013, nuk duhet të kenë asnjë ndikim në planifikimin buxhetor.

8. Në fund, Komiteti e përgëzoi Shqipërinë për rolin konstruktiv në ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe trajtimin e tensioneve ndëretnike në Ballkanin Perëndimor.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2012*



## A E DINI SE?

### Në cilat vende qytetarët mendojnë se të pasurit e meritojnë pasurinë e tyre?

Sipas një hulumtimi të Global Scan, vetëm 39% nga 12.000 persona të intervistuar në 23 vende, mendojnë se të pasurit në vendin e tyre e meritojnë pasurinë që kanë. Përfituesit e të ardhurave më të larta kanë tërhequr kritika të ashpra kur pagat e tyre janë rritur ndërsa ekonomia është në drejtim të kundërt. Europeanët dhe latino amerikanët priren të kenë qëndrime relativisht kritike ndaj të pasurve, ndërsa anglo-saksonët janë më tolerantë. Kontrasti më i madh qëndron mes ekonomive në zhvillim. Në Kinë, ku 600 milion njerëz u nxorrën nga varfëria e skajshme mes viteve 1985 - 2005, gjysma e të rriturve mendojnë se të pasurit e meritojnë pasurinë e tyre. Ndërsa në Rusi, një ekonomi e dominuar nga oligarkët, vetëm 16% e të intervistuarve mendojnë kështu.

### Gjëra të bezdisshme në telefona

*Reklammat në celularë po bëhen gjithnjë e më ndërhyrës në privatësi*

Në 12 korrik, Departamenti Amerikan i Tregtisë mbajti një takim publik në Uashington DC, për të diskutuar aspektet e privatësisë në celularë. Përdoruesit e smartphones dhe telefonave të firmave dixhitale si AdMoB, për të cilën Google ka paguar 750 milionë dollarë në vitin 2010 janë në shtim. Sektori tani është zhvilluar mjaft për t'u bërë objekt shqyrtimi.

Një kompani sigurimi celularësh, ka analizuar Google-Play, dyqanin e Google App dhe ka identifikuar dhjetë ofruesit që përdorin një ose më shumë strategji reklamimi "agresive". Më pas ata kanë kategorizuar programet në gjini të ndryshme për të treguar se cilat lloje kanë më shumë gjasa ta bezdisin përdoruesin me reklama. Këtu përfshihen mekanizma për të ndryshuar desktop-in dhe browser-at që, ndër të tjera, shfaqin ikona të cilat hapin reklama dhe fitojnë akses në të dhënat personale pa paralajmërim.

*Economist Daily Chart, korrik 2012*

**Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)** është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritimit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritimit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, si dhe Programit Europe for Citizens të Komisionit Europian.



Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në faqen e internetit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org).

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: [blerta.hoxha@em-al.org](mailto:blerta.hoxha@em-al.org)